



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo			
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije			
Ministry of Finance			
Arkiva - Arkiva - Archive			
Miria Org. Org. Jedra Org. Unit	01/02	Nr. Prot. Prot. No.	1213/2021
Nr. Faqeve Broj stranica No. pages	2	Data Datum Date	06/08/2021
Prishtinë/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Nr. 44/2021
Datë: 06.08.2021

Në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, në përputhje me dispozitat e nenit 8, paragrafit 1.4. të Rregullores (QRK) Nr.02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M
mbi

Përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e masës 1.1 – Rikthimi në Punë i atyre që kanë Humbur Vendin e Punës gjatë Pandemisë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike

A. FORMA E SUBVENCIONIMIT

1. Mbështetja e punësimit përmes rikthimit në punë tek i njëjti punëdhënës dhe/ose tek një punëdhënës i ri, i gjithë atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë, bëhet në format si në vijim:

1.1.Subvencionim i pagës deri në 50% (pesëdhjetë për qind) të pagës bruto mujore për 3 (tre) muaj.

B. KRITERET PËR SUBVENCIONIM

2. Subvencionimi sipas këtij vendimi bëhet vetëm ndaj atyre punonjësve që i plotësojnë kriteret si në vijim:

2.1.Punonjësi i cili ka qenë i punësuar dhe ishte i deklaruar për qëllime tatimore në periudhën dhjetor/2019 – shkurt/2020 (pa ndërprerje); dhe

2.2. Punonjësi sipas nën paragrafit 2.1 nuk është i punësuar dhe i deklaruar për qëllime tatimore për periudhën prill/2021 – qershor/2021 (pa ndërprerje).

3. Humbja e vendit të punës dhe/ose të qenurit i papunë evidentohet përmes sistemit të Administratës Tatimore të Kosovës.

C. KOHËZGJATJA E SUBVENCIONIMIT

4. Subvencionimi realizohet për tre (3) muaj, duke filluar nga momenti i punësimit dhe deklarimit për qëllime tatimore në sistem të Administratës Tatimore të Kosovës *i.e.*, akti i formalizimit, por jo më herët se periudha korrik 2021.

D. KUFIZIMET NË SUBVENCIONIM

5. Subvencionimi i pagës nuk mund ta tejkalojë shumën 170 (njëqind e shtatëdhjetë) Euro bruto për punonjës, pavarësisht pikës 1.1 të këtij vendimi.

E. NDËRPRERJA E SUBVENCIONIMIT

6. Subvencionimi për punonjësin specifik ndërprehet në momentin e pushimit të marrëdhënies së punës për çfarëdo arsye dhe largimit nga lista e të punësuarve në deklaratën e tatimpaguesit, dhe/ose nuk ju paguhen obligimet tatimore.

F. APLIKIMI PËR SUBVENCIONIM

7. Të drejtë aplikimi kanë shoqëritë tregtare të regjistruara dhe punëdhënësit sipas legjislacionit të Kosovës.
8. Aplikimi bëhet nga punëdhënësit/shoqëritë tregtare përmes sistemit elektronik EDI të Administratës Tatimore të Kosovës përmes formularit të veçantë që është i qasshëm në EDI.
9. Aplikimi mbetet i hapur deri më 15.10.2021.

G. APROVIMI DHE FINALIZIMI I LISTËS SË PËR FITUESVE

10. Administrata Tatimore e Kosovës përmes mediumit elektronik do ta krijojë një formular të thjeshtë elektronik përmes së cilës punëdhënësi dhe/ose punëmarrësi mund ta konfirmojnë paraprakisht nëse punëmarrësi kualifikohet për subvencionim sipas kriterëve të këtij vendimi. Të dhënat që kërkohen për ta bërë një verifikim dhe/ose konfirmim të tillë janë si në vijim:

10.1. Numri personal i punonjësit.

11. Lista finale e të kualifikuarve si përfitues nga subvencionimi sipas këtij vendimi konfirmohet nga Administrata Tatimore e Kosovës, e përpiluar në respektim të plotë të kriterëve të këtij vendimi.

12. Mjetet buxhetore të nevojshme për zbatimin e masës do të ndahen me vendim të veçantë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përkatësisht programi Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës.
13. Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, listën finale me të dhënat e përfituesve, me shumën e aprovuar për pagesë si dhe dokumentacionin tjetër të nevojshëm për regjistrim të shpenzimit në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës e procedon tek Thesari për ekzekutim në baza mujore, në pajtim me pikën 1 të këtij vendimi. Lista përfundimtare përgatitet pas datës pesëmbëdhjetë (15) të muajit vijues.

H. ZBATIMI I VENDIMIT PËR SUBVENCIONIM

14. Pas aprovimit të listës së përfituesve, alokohet buxheti dhe procedohen pagesat e subvencionimit në llogari bankare të punëdhënësit/shoqërisë tregtare.
15. Obligohet Administrata Tatimore e Kosovës, Agjencia e Punësimit e Kosovës dhe Thesari i Kosovës, për zbatimin e plotë të këtij vendimi.

I. HYRJA NË FUQI

16. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hekuran Murati

Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve



Vendimi ju dërgohet:

- Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT-së;
- Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit;
- Drejtorit të Përgjithshëm të APRK-së;
- Arkivit.